



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.28.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË
PODUJEVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, Qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Podujevës në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrë auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Lavdim Maxhuni (Udhëheqës Ekipi) dhe Edon Kabashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
2 Qeverisja.....	10
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	27
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	28
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	31


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2015, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre të dhënë gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat kemi menduar se janë të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrave Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 25.11.2015.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më gjerësisht, shih shtojcën I të këtij raporti).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 është përcaktuar nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

“Opinion i pamodifikuar me Theksim të Çështjes” sepse ka paqartësi në prezantimin e plotë të vlerës neto të pasurive. Për më tepër, 122,587€ shpenzime gabimisht janë regjistruar si pasuri, me çka pasuritë janë mbivlerësuar.


Formulimi i plotë i opinionit është dhënë në hollësi në kapitulli 1.2 i këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Komuna ka bërë veprime për adresimin e rekomandimeve tona dhe ushtron kontrolle në pjesën më të madhe të sistemit të kontrollit të brendshëm, por ende ekzistojnë disa fusha ku dobësitë janë të pranishme.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Menaxhimi i të hyrave nga dhënia me qira e pronës komunale shoqërohet me dobësi, ngase qiramarrësit nuk i kryejnë obligimet e tyre sipas kontratave



Kryetari duhet të siguroj se do ketë monitorim të vazhdueshëm të procesit të dhënies me qira të pronave komunale, dhe se qiramarrësit do t'i kryejnë obligimet e tyre sipas kontratave (shih çështjen 11)

Përgjigja e Menaxhmentit në auditimin 2015

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit në këtë raport, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

Ne e konsiderojmë si të kryer faktin që Kryetari:

- Do ta shqyrtoj raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Deri në fund të muajit janar 2017, do ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2016 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne, gjithashtu, shqyrtojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar, për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

PËR KOMUNËN E PODUJEVËS

OPINIONI I PAMODIFIKUAR ME THEKSIM TË ÇËSHTJES

Ne kemi audituar Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31.12.2015, të cilat përfshijnë 'Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme', 'Pasqyra e Krahasimit të Buxhetit me Shumat Aktuale', Shënimet shpjeguese dhe Shpalosjet.

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave si dhe të buxhetit të realizuar të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31.12. 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën Financiare të Ministrisë së Financave nr. 03/2013/ për Pasqyrat Vjetore Financiare të organizatave buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa për Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të Pasqyrave Vjetore Financiare të Organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Komuna dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushë në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që janë marrë, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen se Regjistri i Pasurive Fikse nuk konfirmon gjendjen e plotë të pasurive, pasi që procesi i regjistrimit ende nuk është përfunduar. Një shumë prej 122,587€ gabimisht ishte regjistruar, dhe për të njëjtën shumë, pasuritë ishin mbivlerësuar. Kjo ishte për shkak se si pasuri kapitale ishin regjistruar shpenzimet që janë bërë për pastrimin e lumenjve, dezinfektimin dhe deratizimin, dhe furnizimin me lule. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Menaxhmenti i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e PVF pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Personat e ngarkuar me qeverisje, si: Kryetari i Komunës, drejtorët dhe zyrtarët financiar janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për Pasqyrat Vjetore Financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse Pasqyrat Vjetore Financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi, Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritët që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për

rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të Pasqyrave Vjetore Financiare.

1.3 Rreziqet domethënëse në PVF

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 25.11.2015, është identifikuar rreziku i mos regjistrimit të të gjitha pasurive që janë në pronësi të Komunës. Edhe pse menaxhmenti ka ndërmarrë veprime për ta minimizuar këtë rrezik, duke regjistruar pasuri gjatë vitit 2015 mbi 6 milion euro, ky rrezik është materializuar për shkak se në regjistrin kontabël figurojnë si pasuri të regjistruara disa shpenzime që janë bërë për pastrimin e lumenjve, dezinfektimin dhe deratizimin, furnizimin me lule, që në total kapin vlerën prej 122,587€.

1.4 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Komuna kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese për PVF dhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me kërkesat buxhetore;
- Raportimet tremujore në Kuvendin Komunal;
- Planin e prokurimit dhe raportimin e progresit të investimeve kapitale mbi 10,000€; dhe
- Pasqyrat nëntëmujore financiare.

Sa i përket kërkesave më lartë, Komuna i kishte trajtuar dhe është në pajtim me kornizën raportuese.

PVF fillestare kanë përmbajtur disa gabime dhe mangësi informatash. Pas sugjerimeve tona, Komuna kishte korrigjuar PVF dhe i kishte dorëzuar përsëri në thesar dhe ZAP. Përveç mbivlerësimit të pasurive për 122,587€ dhe keq klasifikimeve (43,780€) të cilat nuk janë materiale, PVF-të finale janë në pajtim me Rregulloren e MF nr. 03/2013. Vlen të sqarohet se shuma prej

43,780€ ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2015 si investime kapitale, por projektet e paraqitura në tabela, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga Komuna dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF.

1.5 Rekomandimet

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura nga auditimi, përfshirë edhe regjistrimin e plotë të të gjitha pasurive.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballlet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të nxisin përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve, siç janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston ende hapësirë për tu përmirësuar sa i përket qeverisjes brenda Komunës veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut, cilësinë e raportimit menaxherial dhe sistemin auditimit të brendshëm. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit, e plotësuar nga Komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2014 ka rezultuar me 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi me zotimin se të gjitha rekomandimet do të adresohen.

Deri fund të periudhës së auditimit, tri (3) rekomandime ishte adresuar plotësisht, gjashtë (6) janë në proces të implementimit, dhe gjashtë (6) të tjera nuk ishin adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën III në fund të këtij raporti.

Është për t'u vlerësuar fakti se Raporti i auditimit për PVF e vitit 2014 ishte diskutuar edhe në Kuvendin Komunal me datën 31.07.2015, çka ndikon në rritjen e transparencës dhe shqyrtimin më kritik të aktiviteteve të Komunës.

Çështja 1 – Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar sepse Komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e implementimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Si të tilla, në këtë Raport Auditimi përsëri janë ngritur çështje për përmirësim në fusha të caktuara.

Rreziku Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, kanë rezultuar në:

- pagesat nga kodet jo adekuate ekonomike;
- mungesa e komitetit të auditimit; dhe
- jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ tek dhënia në shfrytëzim të pronës komunale.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të forcoj masat e kontrollit dhe të përgjegjësisë ndaj personave të ngarkuar për adresimin të plotë rekomandimeve që veprimet e parashikuara me plan veprimi të zbatohen, në veçanti në fushat e identifikuar me shkallë të lartë rreziku dhe brenda afateve të përcaktuara.

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave (MF) ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në MF. Më poshtë, ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për Komunën. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit, por do ta japë gjendjen për një numër të çështjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Lista kontrolluese e vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura	<p>Si pjesë e auditimit tonë, ne kemi shqyrtuar disa çështje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me disa komponenta. Nga çështjet e shqyrtuara kemi gjetur se:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Procedurat e duhura për menaxhim të rrezikut nuk janë vendosur dhe kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1;2. Komuna nuk ka strategji për zhvillim ekonomik lokal për vitin 2015, por është në proces të hartimit të strategjisë 2016-2018;3. Adresimi i rekomandimeve të ZAP është trajtuar më në hollësi në nënkapitullin 2.3;4. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga Komuna dhe dëshmitë që na janë dhënë e mbështesin këtë konkluzion, edhe pse raportet nuk janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore.5. Auditimi i Brendshëm nuk i ka trajtuar çështjet më lart. Për më shumë, veprimi i ndërmarrë për adresimin e çështjeve të identifikuara nga vetëvlerësimi i vitit 2015 është i limituar, dhe kjo është trajtuar në hollësi në kapitullin 2.6;6. Forma e raportimit që bëhet tek kryetari bëhet sipas nevojës, dhe nuk ka raportime me shkrim prej drejtorëve në baza të rregullta mbi punët dhe aktivitet e tyre (për më shumë shih nënkapitullin 2.5.2).
Rreziku	<p>Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.</p>

Rekomandimi 3 Kryetari duhet të siguroj se proceset e qeverisjes pasohen nga planet strategjike, menaxhimi i rrezikut dhe zbatimi i procedurave për matjen e rezultateve kundrejt objektivave. Gjithashtu, raportimi dhe komunikimi do të përmirësojnë aftësinë e menaxhmentit për të reaguar me kohë ndaj sfidave eventuale.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar në planifikimin e auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit Komuna operon dhe sfidat me të cilat ajo përballet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Udhëzimet e përcaktuara kërkojnë që regjistri i rrezikut të jetë i kompletuar për të mbështetur menaxhimin efektiv operacional dhe strategjik të Komunës.

Çështja 3 - Moszbatimi i kërkesave për Menaxhimin e rrezikut – Prioritet i lartë

E gjetura Pyetësori i vetëvlerësimit të plotësuar ka vërtetuar se Komuna ende nuk ka krijuar procedura formale dhe të dokumentuara të identifikimit dhe menaxhimit të rreziqeve në nivel të organizatës që do të zbusnin ekspozimin ndaj rreziqeve që ndërlidhen me arritjen e objektivave të përcaktuara. Kjo reflekton mungesë të llogaridhënies tek menaxhmenti i lartë lidhur me menaxhimin e regjistrit të rreziqeve si dhe një mungesë njohurie brenda departamenteve për rolet e tyre në ofrimin e mbështetjes për procesin e menaxhimit të rrezikut. Për menaxhimin efektiv të rrezikut nevojiten veprime të qarta, të cilat duhet të zbatohen për të gjitha rreziqet domethënëse që kanë ndikim tek organizata.

Rreziku Mungesa e një procedure formale dhe të dokumentuar të rreziqeve në organizatë do të zvogëlojë cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve pasi çështjet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në këtë nuk adresohen në kohën e duhur.

Rekomandimi 4 Kryetari duhet të sigurojë se do krijohen procedura formale për menaxhimin e rrezikut për organizatën, në mënyrë të përcaktuar dhe ndërmerr veprimet e nevojshme nëse ato ndodhin, si dhe t'i monitoroj në mënyrë sistematike. Hapi i parë në këtë drejtim është hartimi i regjistrit të rreziqeve.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 4 – Dobësi në Kontrolllet Menaxheriale – Prioriteti i lartë

- | | |
|----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| E gjetura | Pas rishikimit të kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të Komunës, ne kemi vërejtur dobësi evidente në raportim. Forma e raportimit që bëhet tek kryetari bëhet sipas nevojës dhe nuk ka raportime me shkrim prej drejtorëve në baza të rregullta përkatëse mbi punët dhe aktivitetet e tyre. Për arsyet e përmendura, ne nuk jemi mbështetur në funksionimin e kontrolleve të nivelit të lartë tek disa kategori ekonomike, si të hyrat, mallrat dhe shërbimet, investimet kapitale, subvencione dhe transfere. |
| Rreziku | Raportimi jo i rregullt nga ana e drejtorive tek Kryetari i Komunës, redukton aftësinë e menaxhmentit për të drejtuar në mënyrë efektive aktivitetet e Komunës, për të reaguar ndaj sfidave financiare në kohën e duhur dhe për të zbatuar kontrollin efektiv të buxhetit. |
| Rekomandimi 5 | Kryetari duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme. |

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB dhe një auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe rreziqet tjera, dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohej nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet efektiv Auditimi.

Çështja 5 – Funkcionimi i NJAB-it dhe komitetit të auditimit – Prioriteti i lartë

E gjetura Njësia e Auditimit të brendshëm për 2015 ka planifikuar 5 auditime, dhe kishte arrit që këtë plan ta realizoj, mirëpo auditimet e kryera nga NJAB kishin të bënë me aktivitetet e vitit 2013 dhe 2014.

NJAB kishte kryer auditime në këto fusha: Paraja e imët, menaxhimi i pasurisë, shpenzimet komunale, të hyrat në shëndetësi, procesi i prokurimit.

Ne kemi marr për testim dosjen e auditimit që kjo njësi e kishte përfunduar për raportin në fushën e prokurimit dhe kemi konstatuar se mungon programi i auditimit dhe mungojnë dëshmitë e gjetjeve që ishin deponuar në dosje.

Ne gjatë auditimit kemi vërejtur se menaxhmenti i kishte implementuar pjesërisht rekomandimet të dhëna nga NJAB-i.

Me kalimin e mandatit, nuk është ri themeluar Komiteti i Auditimit dhe nuk janë mbajtur takime gjatë këtij viti.

Rreziku Neglizhenca e menaxhmentit për adresimin e rekomandimeve të dala nga NJAB-i rritë rrezikun që dobësitë e identifikuar të përsëriten. Ndjekja e ngjarjeve nga auditimi pasi ato të kenë ndodhur, nuk i shton vlerë përmirësimit të operacioneve dhe parandalimit të gabimeve dhe parregullsive. Po ashtu, mungesa e programit të auditimit dhe dëshmime që konfirmojnë gjetjet e auditimit nga NJAB, rritë rrezikun se raportet të jenë të një cilësie të dobët, të pa dokumentuara dhe jo korrekte.

Rekomandimi 6 Kryetari duhet të diskutoj një plan veprimi me nivelet tjera menaxhuese dhe të përcaktoj stafin përgjegjës dhe afatet për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm. Një proces monitorimi mbi progresin, gjithashtu duhet të vendoset. Në identifikimin e çështjeve për trajtim, NJAB duhet të fokusohet më shumë në aktivitetet e vitit aktual, me prioritet në fushat ku rreziku vlerësohet i nivelit të lartë. Procesi i auditimit duhet të zhvillohet në pajtim me standardet dhe të jetë mirë i dokumentuar.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin 2, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Të hyrat nga qiraja për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale mbeten ende një sfidë, sepse kontratat me qiramarrësit nuk janë respektuar, dhe kjo ka rezultuar me ngecje në inkasimin e të hyrave nga ana e Komunës. Fushat tjera ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit nëpër kategori ekonomike, prokurimi, si dhe vendosja e kriterëve të matshme me rastin e subvencionimit. Kontrollët mbi të hyrat nga tatimi në pronë, në përgjithësi janë të mira dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e arkëtuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Shpenzimet	2014 Shpenzimet	2013 Shpenzimet
Burimet e Fondeve:	18,306,493	19,220,813	17,924,828	17,609,542	16,666,356
Granti i Qeverisë - Buxheti	16,708,901	16,974,706	16,753,127	16,483,147	15,268,355
Të bartura nga viti paraprak ²	-	297,039	169,548	178,113	273,407
Të hyrat vetjake ³	1,597,592	1,597,592	898,769	913,322	816,334
Donacionet e brendshme	-	-	-	-	-
Donacionet e jashtme	-	351,476	103,384	34,960	308,260

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual të përdorura për vetëfinancim.

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 914,320€. Kjo rritje është rezultat i vendimit të qeverisë me datën 16.12.2015 për plotësimin e deficitit në paga dhe mëditje për punëtorët e arsimit në shumë 265,805€, për të hyrat e bartura me vlerë prej 297,039€ si dhe donacioneve të jashtme me vlerë 351,474€.

Në vitin 2015 Komuna ka shpenzuar 93% të buxhetit final, përafërsisht në shkallë të njëjtë me vitin e kaluar (93%). Në përgjithësi, kjo mund të konsiderohet një performancë e mirë e ekzekutimit buxhetor.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Shpenzimi	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	18,306,493	19,220,813	17,924,828	17,609,542	16,666,356
Pagat dhe Mëditjet	11,000,000	11,331,381	11,286,703	10,375,596	9,003,807
Mallrat dhe Shërbimet	1,061,718	1,138,276	992,577	953,258	1,044,555
Shërbimet komunale	324,500	324,500	322,522	288,442	303,122
Subvencionet dhe Transferet	692,000	696,000	555,714	423,913	349,065
Investimet Kapitale	5,228,275	5,730,656	4,767,312	5,568,333	5,965,807

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Ndryshimi tek kategoria e pagave dhe mëditjeve prej buxhetit fillestar në atë final është 331,381€. Kjo ka ndodhur për arsye se Qeveria e Kosovës ka marrë vendim me datën 16.12.2015 për mbulimin e deficitit në pagat për arsim në shumë 265,805€. Po ashtu, ndryshime në mes buxhetit fillestar dhe atij final kishte edhe tek donacionet dhe të hyrat e bartura në vlerë prej 65,576€, që ishin destinuar për fondin e pagave.
- Te kategoria e mallrave dhe shërbimeve kemi rritje të buxhetit final në krahasim me atë fillestar për 76,558€. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i hyrave vetjake të bartura për 3,783€ dhe donacioneve të jashtme për 72,775€;
- Komuna ka pranuar gjithashtu grante nga donatorët e jashtëm në vlerë 351,476€, ndërsa prej tyre janë shpenzuar 103,384€ për kategorinë e investimeve kapitale, mallra dhe shërbime dhe paga dhe mëditje; dhe
- Te kategoria e investimeve kapitale, ka pasur rritje të buxhetit final në raport me atë fillestar për 502,380€. Rritja ka ardhur si rezultat i të hyrave të bartura prej 259,680€ dhe donacioneve të jashtme për 242,700€. Nga shumat në dispozicion për investime kapitale, komuna ka shpenzuar 83%, një performancë që ka nevojë të përmirësohet.

Tabela 3. Të hyrat vetjake të Komunës – pranimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Pranimet	2014 Pranimet	2013 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,597,592	1,597,592	1,180,319	1,199,576	1,005,192

Të hyrat vetjake vjetore gjatë vitit 2015 ishin realizuar 74% nga shuma e planifikuar. Arsyet e një realizimi kaq të ultë, po i cekim në vijim:

Drejtorja e pronës, kadastrit dhe gjeodezisë ka pasur ngecje në realizimin e kontratave për pronat e dhëna me qira, ngase shumë nga obligimet sipas kontratave nuk janë përmbushë nga ana e shfrytëzuesve.

Edhe drejtorja e urbanizimit kishte dështuar në përmbushjen e planit. Nga shuma prej 180,592€ e planifikuar nga lejet e ndërtimit, ishin realizuar vetëm 85,402€. Kjo ka ndodhur për shkak se ligji për legalizim parasheh tarifa të larta për legalizimin e objekteve, dhe si rezultat, qytetarët nuk kanë bërë kërkesa për t'i legalizuar objektet.

Në anën tjetër, listat e debitorëve ndaj Komunës kanë kaluar shifrën prej 7 milionë, që paraqet një shumë domethënëse për Komunën, dhe gjendja e llogarive të arkëtueshme është në rritje të vazhdueshme.

Çështja 6 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Realizimi i buxhetit në nivel të përgjithshëm ishte në nivel të kënaqshëm, mirëpo brenda kategorive ekonomike ka pasur ngecje në realizim, si: investimet kapitale (83%), mallrat dhe shërbimet (81%) dhe subvencionet (80%). Arsyet të cilat kanë ndikuar për një performancë të tillë, kanë qenë dështimi i dy procedurave të prokurimit, për shkak të ankesave nga operatorët ekonomik në OSHP, dhe inkasimi i pa mjaftueshëm i të hyrave vetjake në nivelet e planifikuara.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i të hyrave ka reflektuar edhe në shkallën e ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit, rrjedhimisht edhe në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxheti i vitit 2016.
- Rekomandimi 7** Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore, si të hyrat, ashtu edhe shpenzimet brenda kategorive ekonomike dhe të identifikojë dhe adresojë me kohë barrierat për ekzekutimin maksimal të buxhetit.

3.4 Prokurimi

Shpenzimet e prokurimit gjatë vitit ishin 4.8 milionë euro. Rregullat e prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit të tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Ne kemi analizuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në PIP dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu, kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim në projektet e parapara për tu realizuar gjatë vitit. Vlerësimet tona janë se nuk ka ndonjë çështje për t'u ngritur në këtë raport.

Ne gjithashtu kemi bërë edhe vlerësimin e zbatimit të procedurave dhe testet tona kanë identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 7 – Dobësi sistematike në prokurim – Prioritet i mesëm

E gjetura	Sipas nenit 81 të LPP dhe nenit 55 të Udhëzuesit operativ për prokurimin publik, autoriteti kontraktues duhet të hartoj një plan për menaxhim të kontratës. Ne kemi identifikuar se për kontratat e nënshkruara për mallra dhe shërbime nuk ishte përgatitur ndonjë plan për menaxhimin e kontratave.
Rreziku	Mungesa e planit për menaxhimin e kontratës rritë rrezikun që kontratat e tilla të mos përmbushen sipas specifikave të kontraktuara.
Rekomandimi 8	Kryetari duhet të sigurojë se menaxheri i prokurimit duhet të insistoj që për çdo kontratë prokurimi të caktohen personat adekuat për menaxhimin e kontratave, dhe vetëm pas konfirmimit të menaxherit të kontratës, e njëjta të konsiderohet e përfunduar.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

Shpenzimet tjera janë shpenzime të cilat nuk i nënshtrohen procedurave të prokurimit. Tek shpenzimet pa prokurim, kemi vërejtur se komuna kishte lidhur kontrata për shërbime të veçanta të cilat ishin paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

Çështja 8 – Kontrata për shërbime të veçanta – Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna ka të punësuar punëtorë me kontrata për shërbime të veçanta. Ne kemi identifikuar se 13 kontrata kanë kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj e ndër to kishte edhe kontrata të lidhura që nga viti 2010. Sipas nenit 12 pika 4 të Ligjit për shërbyesit civil, kontratat për shërbime të veçanta mund të lidhen për një periudhë më të shkurtër se 6 muaj.
- Rreziku** Ripërtëritja e këtyre kontratave rritë rrezikun që shërbimet e tilla të mos jenë reale me nevojat e Komunës dhe që buxheti i planifikuar për këtë kategori të mos shpenzohet sipas qëllimit të caktuar. Për më tepër, mund të punësohet stafi jo kompetent dhe shërbimet e ofruara të mos jenë cilësore.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet të siguroj se kontratat për shërbime të veçanta të përdoren për qëllime specifike aty ku me të vërtet ka mungesë të kuadrit si dhe kohëzgjatja e tyre mos të jetë mbi 6 muaj siç e përcakton ligji. Ne sugjerojmë që praktikën e tilla të mos përsëriten.

3.5.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 11,331,381€, ndërsa shpenzimet 11,286,703€ apo 99%.

Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave, pensionet, dhe pagesat për anëtarët e kuvendit komunal. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5.2 Subvencionet dhe Transferet

Në vitin 2015 komuna ka bërë ndarjen e subvencioneve për entitete publike dhe jo publike. Nga kjo kategori kemi testuar pagesat dhe kemi rishikuar nëse këto janë bërë në përputhje me rregulloren e ndarjes të subvencioneve. Disa nga mangësitë janë prezantuar më poshtë:

Çështja 9 – Mungesa e dëshmime me rastin e përzgjedhjes së përfituesve - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte subvencionuar ndërtimin e serrave individuale me vlerë 146,554€, ku kishin aplikuar 120 fermerë. Sipas raportit të komisionit, 90% prej tyre i kishin plotësuar kriteret e vendosura me konkurs, ndërsa kanë përfituar 30 fermerë. Neve nuk na janë ofruar dëshmi se si janë përzgjedhë këta 30 përfitues në mesin e 120 aplikuesve.

Komuna kishte subvencionuar bletarët me shoqëri bletësh (koshere) 99,500€, ku kishin aplikuar gjithsejtë 330 bletarë. Sipas raportit të komisionit 90% e tyre i kishin plotësuar kriteret e vendosura me konkurs, ndërsa kanë përfituar 100 bletarë. Neve nuk na janë ofruar dëshmi se si janë përzgjedhë këta 100 përfitues në mesin e 330 aplikuesve.

Rreziku Mungesa e transparencës në procesin e ndarjes së subvencioneve shpie në konkludimin që përfituesit e subvencioneve të mos jenë përfituesit më meritor. Kjo rrit rrezikun që subvencionet e dhëna të mos arrijnë objektivat e synuara.

Rekomandimi 10 Kryetari duhet të siguroj se me rastin e subvencionimit të fermerëve do të demonstron një transparencë maksimale dhe përzgjedhja e përfituesve të bëhet në bazë të kushteve dhe kriterëve të përcaktuar. Një proces i monitorimit të kohëpaskohshëm nëse subvencionet po përdoren për qëllimet përkatëse, duhet të aplikohet.

3.6 Të Hyrat vetjake

Të hyrat e realizuara nga komuna në vitin 2015 ishin 1,180,319€. Zërat kryesor që përbëjnë shumat e mbledhura janë: Të hyrat nga tatimi në pronë; Taksa për regjistrimin e automjeteve, Të hyrat nga taksa administrative, etj.

Çështja 10 – Tatimi në pronë – Prioritet i lartë

E gjetura Komuna nga tatimi në pronë për vitin 2015 kishte planifikuar që të realizoj shumën prej 312,000€, ndërsa ka realizuar 393,158€. Gjithsej ishin faturuar 18,778 obligues tatimor me një ngarkesë prej 486,092€. Nëse e krahasojmë me faturimin atëherë inkasimi del të jetë rreth 81%, ndërsa në krahasim me planin, ka një tejkalim të planit prej 26%. Pra, ekzistojnë shpërputhje të mëdha në mes planit, faturimit dhe inkasimit.

Ne kemi testuar shtatë mostra nga tatimi në pronë dhe nga kjo kemi vërejtur se borxhet për vitin 2015 vetëm për këto raste ishin 10,388€. Borxhet e tatimit në pronë në vitin 2015 ishin rritur për 199,071€ apo 7% krahasuar me një vit më parë, përkatësisht nga 2,728,611€ në 2,927,682€.

Komuna nuk kishte arritur të kryej verifikimin e 1/3 e pronave të paluajtshme, siç kërkohet me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr. 03/L-204 dhe udhëzimin administrativ nr. 03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin. Ne kemi vërejtur se komuna nuk ka arritur të azhurnoj sistemin me informatat më të reja, për shkak se ka pasur mungesa të zyrtarëve anketues në terren për verifikim të pronave.

Rreziku Rritja e borxheve prej viti në vit rritë rrezikun se mjetet nuk do mund të realizohen dhe kjo rrezikon arritjen e objektivave të Komunës që janë parashikuar.

Mos verifikimi i 1/3 të pronave mund të rezultojë me mangësinë e informatave të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të siguroj një rishikim të sistemeve ekzistuese për të konfirmuar nëse mekanizmat që ka vendosur për mbledhjen e të hyrave mund të funksionojnë në mënyrë efektive, dhe se veprime shtesë janë ndërmarr që të siguroj se tatimet mbledhen në nivelet e parashikuara. Verifikimi i pronave komunale duhet të bëhet siç parashih ligji në mënyrë që në bazën e të dhënave të integrohen të gjitha ndryshimet eventuale tek pronat, të vlefshme për bazën e tatueshme.

Çështja 11 – Të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale – Prioritet i lartë

E gjetura Nga pronat e dhëna me qira, komuna kishte planifikuar që të realizoj 60,000€, detyrimet sipas kontratave ishin 132,794€, ndërkaq kishte inkasuar shumën prej 59,579€.

Ne kemi testuar 6 mostra të dhënies me qira të pronës komunale dhe kemi identifikuar këto dobësi:

Në tri raste komuna kishte lidhë kontrata në vitin 2012 për dhënie në shfrytëzim të lokaleve afariste.. Kontratat nuk ishin zbatuar pasi që qiramarrësit nuk kishin bërë pagesat sipas kontratës. Borxhi total i grumbulluar ishte 25,726€. Menaxhmenti nuk kishte ndërmarr asgjë për t'i obliguar këta qiramarrës që t'i kryejnë obligimet e tyre ndaj Komunës.

Në një rast komuna vazhdon ta ngarkoj një subjekt afarist me qira mujore prej 700€ për shfrytëzim të paluajtëshmërisë, edhe pse kontrata kishte skaduar në vitin 2006. Që nga ajo periudhë ky shfrytëzues vazhdon ta shfrytëzoj këtë pronë pa kontratë, ndërsa borxhi total arrin vlerën 77,700€.

Po ashtu, në një rast tjetër komuna kishte lidhur kontratë me datën 19.07.2013 për shfrytëzimin e hapësirave publike për vendosjen e bilbordave në qytet. Pagesa për një vit që duhet ta paguajë qiramarrësi ishte 8,736€. Ky shfrytëzues nuk kishte paguar asnjëherë ndaj Komunës dhe borxhi total kishte arritur shumën 21,840€. Më tutje, komuna me datën 23.12.2015 ia kishte shkëputur kontratën këtij operatori dhe rastin e kishte dërguar tek përmbaruesi për ekzekutim, mirëpo Inspeksioni komunal në procesverbal të datës 27.02.2016 konfirmon se hapësirat janë duke u shfrytëzuar ende dhe pa kontratë.

Rreziku Menaxhimi i dobët i kontratave të qirave ka rezultuar me një evazion të lartë të mos pagesave nga ana e qiramarrësve dhe shfrytëzimin e pronave publike në mënyrë të kundërligjshme. Kjo rritë rrezikun që shumat e grumbulluara të qirave të pa paguara të mos inkasohen as në të ardhmen.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se asnjë pronë publike nuk do të lejohet të shfrytëzohet dhe keqpërdoret pa pagesën e qirave të parapara me kontratë. Ne rekomandojmë që të merren masa të menjëhershme dhe të shqyrtohet në mënyrë kritike lista e debitorëve dhe arsyet pse ekziston kjo gjendje. Veprimet e duhura të merren sa më parë për të parandaluar vazhdimin e praktikave të tilla.

Çështja 12- Të hyrat nga taksa në firmë - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna ka inkasuar gjithsej 55,802€, për vitin 2015 nga taksa për ushtrimin e veprimtarisë. Në Komunën e Podujevës operojnë afro 2937 biznese, ku shuma e ngarkuar sipas tarifave ishte 269,379€. Ne kemi testuar 10 mostra ku kemi vërejtur se tetë (8) prej tyre nuk i kanë kryer obligimet dhe borxhi total i tyre ndaj Komunës është 49,340€. Shuma e këtyre llogarive të arkëtueshme po rritet prej viti në vit, dhe se në vitin 2015 gjendja e llogarive është 3,434,829€, ndërsa në fund të vitit 2014 ka qenë 3,239,302€, pra shihet një rritje për 195,527€.
- Rreziku** Politikat e inkasimit duket të jenë të dobëta dhe joefektive për të siguruar maksimizimin e të hyrave. Vonesat në mbledhjen e të hyrave sjellin dështimet në vendimarrjen e menaxhmentit për financimin e projekteve të parashikuara nga fondet vetjake.
- Rekomandimi 13** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se do merren masa të shpejta për vendosjen e mekanizmave dhe kontrolleve të duhura për t'i mbledhur borxhet e prapambetura. Drejtoria e financave, gjithashtu duhet të forcoj kontrollet që këto taksa t'i inkasoj me kohë dhe të jetë më e vendosur në adresimin e këtij problemi.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Në vitin 2014 vlera neto e pasurive në regjistrin kontabël ishte 70,112,742€, ndërsa në vitin 2015 kjo vlerë ishte rritur në 76,254,776€. Siç shihet, komuna ka vazhduar me procesin e regjistrimit të pasurive dhe ka bërë një progres të mirë në vitin 2015, por deri në kompletimin e një regjistri përfundimtar të pasurive mbetet edhe shumë për t'u bërë.

Çështja 13- Mungesa e regjistrimit të plotë të pasurive dhe mos pajtueshmëri me rregulloren e menaxhimit të pasurive - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas nenit 4 të Rregullores për Menaxhim të Pasurive, Komuna duhet të posedojë informata se me çfarë pasurie është i ngarkuar dhe ka në përdorim stafi në administratën komunale. Komuna në regjistrat e saj të pasurive posedon të dhëna për pasurinë që ngarkohet secila Drejtori, e jo të dhëna për zyrtar.

Komuna nuk ka procedura të brendshme të shkruara për menaxhimin e pasurive, siç kërkohet me rregulloren për menaxhimin pasurisë 02/2013.

Kryetari i Komunës me datën 16.11.2015 kishte formuar komisionin për inventarizimin e pasurisë jo financiare në pronësi të Komunës. Sipas rregullores për menaxhimin e pasurisë komisioni duhej ta përfundonte punën deri në mbylljen e vitit fiskal në mënyrë që ndryshimet të harmonizohen me PVF-të e vitit 2015, mirëpo ky komision nuk ka përgatitur ndonjë raport me shkrim për rezultatet e inventarizimit dhe regjistrimeve të fund vitit.

Rreziku Komuna nuk i është përmbajtur në tërësi rregullores për menaxhimin e pasurisë, ku mungesa e kontrolleve në mirëmbajtjen e regjistrit kontabël dhe mos regjistrimi i pasurisë sipas kërkesave të rregullores për menaxhim të pasurive, mund të shpie në humbjen, keqpërdorimin dhe përdorimin e paautorizuar të pasurive publike.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të siguroj hartimin e një udhëzuesi të brendshëm për menaxhim të pasurive ku qartësohen rolet dhe detyrat e zyrtarëve të caktuar të cilët duhet të kontribuojnë në përgatitjen e të dhënave për pasurinë që duhet regjistruar, dhe më pas, të gjitha pasuritë të prezantohen drejt në PVF.

3.7.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte 172,801€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016.

Çështja 14 – Mungesa e një protokollit për evidentimin e faturave - Prioritet i mesëm

E gjetura Ne kemi testuar 19 fatura të papaguara që janë raportuar si borxhe në Ministrinë e Financave dhe kemi konstatuar se komuna nuk i ka kryer obligimet brenda afatit të paraparë prej 30 ditësh, për arsye të mungesës së mjeteve. Po ashtu, komuna me rastin e ardhjes së faturave, nuk i protokollon ato në zyrën e veçantë të protokollit, por pranimi bëhet nga tri drejtoritë, si: administrata, shëndetësia dhe arsimi.

Obligimet e papaguara në shumë prej 18,416€, të identifikuar në 13 fatura të vitit të kaluar nuk ishin shpalosur në PVF të vitit 2014, ndërkaq pagesat janë kryer në vitin 2015.

Rreziku Mungesa e protokollit me rastin e ardhjes së faturave, rritë rrezikun e raportimit jo të drejtë të obligimeve, pagesës së dyfishtë apo edhe humbjes së faturave.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të siguroj se të gjitha faturat do pranohen nga zyra pritëse (arkiva), të protokolohen, dhe të distribuohen në Drejtoritë përkatëse në mënyrë që të ketë një raportim të drejtë dhe evidenca të plota mbi detyrimet e Komunës.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimi të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuar	Të adresuara por jo te implementuar	Të pa adresuara
1. Rreziqet domethënëse në PVF	Kryetari duhet të siguroj se janë ndërmarr të gjitha veprimet që shpenzimet të bëhen sipas ndarjeve buxhetore dhe regjistrimet do të bëhen sipas kodeve ekonomike adekuate.			Jo
1.1 Rreziqet domethënëse në PVF	Kryetari duhet të identifikojë veprimin e duhur për t'i adresuar këto dobësi të kontrolleve në mënyrë që të mundësojë një prezantim të drejtë dhe të vërtetë të pasurive në vitin 2015.		Pjesërisht	
2. Procesi i përgatitjes së PVF	Kryetari duhet të sigurojë që plani i prodhimit të llogarive për vitin 2015 formalisht adreson të gjitha kërkesat për pajtueshmëri lidhur me PVF-të, duke përfshirë edhe mungesën e informatave të përmendura.		Pjesërisht	
3.Rekomandimeve nga viti paraprakë	Kryetari duhet të siguroj që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuara me fokus fillestar në ato të një rëndësie më të madhe.		Pjesërisht	
4.1 Proceset e llogaridhënjesë	Kryetari duhet të zbatojë një rishikim për të përcaktuar formatin e nevojshëm të raportimit për të gjitha aktivitetet për menaxhmentin e lartë që është kërkesë për mbështetjen e një menaxhimi efektiv të punës. Kjo duhet të mbështetet nga një strukturë qeverisëse ku menaxhmenti i lartë është i njoftuar mbi dobësitë e kontrolleve dhe t'i menaxhojë ato në mënyrë efektive.			Jo

4.2 Pagesat sipas vendimeve gjyqësore dhe nenit 39.2 LMFPF	Kryetari duhet të siguroj se do të bëj një planifikim të mirëfilltë të buxhetit, të ngris disiplinën financiare për kryerjen e pagesave me kohë si dhe do t'i rishikoj të gjitha obligimet e mbetura në mënyrë që të evitoj çrregullimet e tilla buxhetore.		Pjesërisht	
4.3.1 Te hyrat nga qiraja	Kryetari duhet të siguroj se do të respektohen të gjitha kushtet e kontratave tek dhënia e pronës komunale me qira dhe identifikoj arsytet pse nuk po kryhen obligimet, e pastaj të ndërmerren masa që qiramarrësit t'i kryejnë obligimet në çdo muaj siç specifikohet me kontrata.			Jo
4.3.2 Tatimi në pronë	Kryetari duhet të sigurojë se do bëhet identifikimi i pengesave në inkasimin e të hyrave dhe do të hartohet një plani konkret i cili do të rriste shkallën e realizueshmërisë së të hyrave në mënyrë që shkalla e borxheve të pa mbledhura të ulet në nivelin minimal.		Pjesërisht	
4.4.1 Prokurimi	Kryetari duhet të inicioj rishikimin pse kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë në rastet e mësipërme dhe të ushtrojë kontrolle më të mira për të siguruar që situata të tilla nuk do të përsëriten.	Po		
4.4.2 Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të siguroj se kontratat për shërbime të veçanta përdoren vetëm për shërbime specifike aty ku me të vërtet ka mungesë të kuadrit si dhe kohëzgjatja e tyre mos të jetë mbi 6 muaj siç e përcakton ligji.			Jo
4.4.2.1 Pagesat sipas marrëveshjeve	Kryetari duhet të sigurojë se një praktikë e tillë e marrëveshjeve dhe realizimi i pagesave shumë kohë para se të fillojë projekti, nuk do të përsëritet në të ardhmen. Përveç kësaj, marrëveshja duhet të sigurojë raportim të mirëfilltë financiar dhe monitorim cilësor.	Po		

4.4.3 Kompensimet	Kryetari duhet të siguroj se kontrollet gjatë procesimit të pagave të forcohen dhe që ndalesat dhe kompensimet të bëhen në përputhje me ligjet në fuqi. Gjithashtu, çështja e akt emërimeve duhet të rregullohet në pajtim me kërkesat ligjore, si dhe asnjë pagesë për punët shtesë të mos bëhet pa konfirmimet e duhura dhe aprovimet përkatëse.	Po		
4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryetari duhet të siguroj hartimin e një udhëzuesi të brendshëm për menaxhim të pasurive ku qartësohen rolet dhe detyrat e zyrtarëve të caktuar të cilët duhet të kontribuojnë në përgatitjen e të dhënave për pasurinë që duhet regjistruar dhe i cili paraqet edhe kriteret për vlerësimin e kategorive të pasurive, evidencën dhe ruajtjen e tyre.		Pjesërisht	
4.5.2 Trajtimi i borxheve	Kryetari duhet të siguroj se të gjitha faturat do të pranohen nga zyra pritëse (arkiva) dhe të protokolohen në mënyrë që të ketë një raportim të drejtë të gjitha obligimeve dhe me kohë.			Jo
4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryetari duhet të siguroj se fokusi i punës së NJAB do të jenë aktivitetet aktuale të Komunës si dhe ndihma, këshillat, sugjerimet dhe rekomandimet në kuptim të ofrimit të sigurisë për efektivitetin dhe operimin e kontrolleve të brendshme dhe jo përshkrimi i tyre pasi ato të kenë ndodhur. Gjithashtu, të aktivizohet Komiteti i auditimit.			Jo